

FJALA E DEPUTETES BLERINA GJYLAMETI

E ENJTE 15 NËNTOR 2021

E nderuar Kryetare,

Të nderuar kolegë deputetë,

Diskutimi dhe vendimmarrja në lidhje me politikat ekonomike dhe për më tepër ato buxhetore në tre vitet e fundit, sigurisht, nuk janë aspak të lehta për asnjë shumicë, aq më tepër për vende të vogla si vendi ynë. Në 2019-n kapacitetet tona do të sfidoheshin nga tërmeti, dhe për ta bërë edhe më të vështirë gjatë vitit 2020, vendi ynë do të përballej edhe me një tjetër sfidë: Covid-19. Ashtu si e gjithë bota, edhe vendi ynë nuk mund të ishte imun ndaj kësaj pandemie, aq më tepër me pasojat e saj në ekonomi. Për fat të mirë, viti që po lëmë pas shënoi dhe një rigjallërim të ekonomisë, sidomos në sektorin privat. Gjatë këtij viti është shënuar një rritje e ndjeshme e të ardhurave, që ka ardhur edhe nga lehtësirat dhe frymëmarrja që mori sektori privat, po ashtu edhe nga rritja e investimeve shtetërore në përgjithësi dhe në mënyrë të veçantë në sektorin e ndërtimit. Nëse kthejmë kokën pas dhe shikojmë se çfarë ka ndodhur, gjatë këtij viti është shënuar një rritje e rëndësishme e volumit të eksportimporteve, turizmit dhe prodhimit, e shoqëruar kjo me rritjen e kërkesës së brendshme, ndërkohë që një vëmendje e veçantë është treguar dhe ndaj përmirësimit të luftës kundër informalitetit dhe evazionit fiskal. Jam realiste këtu, dhe është për t'u mirëkuptuar çdokush në këtë sallë, që shpreh shqetësim apo rezerva në lidhje me situatën ekonomike. Edhe unë vetë, si deputete e kësaj maxhorance, si çdokush tjetër në këtë sallë, do të doja të ishte bërë më shumë dhe shumë më mirë, por duhet të kemi parasysh një fakt: në një ekonomi globale, ekonominë e vendeve si yni, atakohen më shumë. Vendimet e marra në këta dy vjet nuk kanë qenë të lehta për askënd.

Nga njëra anë, ka qenë domosdoshmëria për të vendosur kufizime, çka preku pothuajse gjithë sektorët ekonomikë e për pasojë edhe të ardhurat në shtet dhe, nga ana tjetër, nevoja për t'i dhënë frymëmarrje ekonomisë, e cila u kontraktua nëpërmjet ndihmës për bizneset, por dhe për qytetarët që u prekën. Falë stimujve ekonomikë dhe hapjes së ekonomisë, në 10 muajt e parë aktiviteti ekonomik në vend arriti një rikuperim të shpejtë, duke na çuar në një rritje ekonomike 7,6%. Përmirësimi i besimit të familjeve dhe bizneseve, si dhe stimuli ekonomik, fiskal e monetar në ekonomi, rritja e vaksinimit, rritja e kredisë dhe rimëkëmbja e aktivitetit ekonomik me partnerët tregtarë, rritën ndjeshëm jo vetëm konsumin e brendshëm dhe aktivitetin tregtar, por edhe kërkesën e brendshme, duke ndikuar pozitivisht në rikuperimin e ekonomisë shqiptare. Sektorët që ndikuan më shumë në këtë rritje ekonomike ishin ndërtimi, industria dhe shërbimet. Edhe pasqyra e tregut të punës ka ardhur duke u përmirësuar, ku norma e papunësisë zbriti nga 12,2% në vitin 2020, në 11,4% në vitin 2021. Në fakt, i ndoqa me vëmendje diskutimet e pothuajse të gjithë kolegëve të opozitës dhe ajo që konstatova, për fat të keq, është se opozita edhe sot nuk arrin të ngrihet në nivelin e përgjegjësisë që i takon një force të tillë politike, që dikur braktisi vendet e saj në këtë sallë, kur shumë mirë duhet të ishte një alternativë dhe një katalizatore e reformave, por, për fat të keq, edhe me rikthimin vijon avazin dhe lojën e vjetër, atë të vajtimit.

Pas shkatërrimit të kauzës së tyre politike të zgjedhjeve, i siguroj se dhe kauzat e tjera, që po mundohen t'i ngrenë këtu sot e prej disa ditëve, që kur janë kthyer në sallën e parlamentit, si koncesionet, infrastruktura, shëndetësia, nuk i shpëtojnë aspak nga uji në të cilin janë futur. Flisni për

infrastrukturë, a thua se shqiptarët harruan se si i nisnit punët sa herë kishte zgjedhje, vetëm thjesht për të prerë shirita dhe rrugët i linit rrugëve! Folët për mbetjet. Po ju e kujtoni mjaft mirë se si në gusht të vitit 2013, ai që sot është kryetari i opozitës, Lulzim Basha, aso kohe në drejtim të Bashkisë së Tiranës, nisi tratativat për menaxhimin e plehrave të qytetit nga privatët. Kjo kontratë, e cila sugjerohej nga kryetari i opozitës aktuale, kishte një çmim prej 37 lekësh për mbledhjen e mbetjeve, që do të thotë shumë më tepër se çmimi që paguhet sot, dhe kontrata ishte me një afat 20-vjeçar, përsëri shumë më tepër se afati i kontratës aktuale. Folët për gjendjen në shëndetësi. Sigurisht, është një sektor që, sado të bësh, ka ende shumë nevoja dhe ato nuk mbarojnë asnjëherë, por është e sigurt që personelit mjekësor, mbi të gjitha, i është rikthyer dinjiteti. Pandemia tregoi më së miri që kapacitetet spitalore janë në nivelet e duhura, edhe pse u përballëm me një situatë të jashtëzakonshme, e krahas infrastrukturës spitalore, në vitin 2022 do të rriten rrogat me 6% për mjekët dhe infermierët. 111 milionë dollarë janë për rimbursimin e barnave, prej të cilave përfitojnë 400 mijë qytetarë. Flisni për rindërtimin, por a ju kujtohen përmbytjet në Shkodër dhe në Vaun e Dejës? Premtuat dëmshpërblime, që nuk i bëtë kurrë realitet dhe i braktisët qytetarët që ju shikonin si përfaqësuesit e tyre, pasi dhe më së shumti ata kanë mbështetur Partinë Demokratike. U desh të vinin socialistet në pushtet për të shlyer detyrimet që kishit lënë ju.

Vetëm në dy vjet, mbi 48 mijë familje kanë përfituar nga programi i rindërtimit, duke përfshirë këtu edhe grantet e rikonstruksionit dhe të rindërtimit; 47 miliardë lekë janë alokuar nga buxheti i shtetit deri tani, prej të cilave 15 mijë familje trajtohen me bonus qiraje në vlerën 4,4 miliardë lekë dhe do të vazhdojnë t'i marrin këto bonuse deri në ditën kur do të hyjnë në shtëpitë e reja, ndërsa 33 mijë qytetarë janë paguar për të ndërtuar shtëpitë e tyre. Të tilla shifra flasin për vëmendje të vazhdueshme ndaj nevojave të komunitetit. Nuk bëhet fjalë vetëm për ndërtimin e një banese apo të një pallati, por bëhet fjalë për ndërtimin e një komuniteti të tërë, për një rilindje të qyteteve me të gjithë infrastrukturën e nevojshme, për të krijuar dhe perspektiva të reja zhvillimore. Meqenëse kryetarin aktual e keni pasur kryetar të Bashkisë së Tiranës, kolegë të opozitës, më tregoni, se kemi pasur debate të vazhdueshme në Komisionin e Medias: sa shkolla ndërtoi ai në Tiranë kur ishte kryetar bashkie? Mjafton t'ju them se shkollat që janë ndërtuar në Tiranë janë shumë më tepër se shkollat që keni ndërtuar ju në 8 vjet në krye të vendit. Përsëri këtu shifrat janë kokëforte, flasin vetë. Edhe buxheti 2022 synon pikërisht konsolidimin e mëtejshëm të rimëkëmbjes ekonomike. Të ardhurat e buxhetit të shtetit, në krahasim me pritshmëritë për vitin 2021, rriten me 7,8%, ndërkohë që të ardhurat nga tatimet dhe doganat parashikohen të rriten me 9,9 %, për shkak të përmirësimit të administrimit fiskal dhe luftës pa kompromis kundër informalitetit. Më vjen mirë që edhe ky buxhet i ri krijon hapësirat e nevojshme për të vijuar me reformat, krahas rritjes ekonomike. Me lehtësitë fiskale biznesi merr një frymëmarrje tjetër, duke vijuar që të dhënat që kemi sot t'i shikojmë prapë me optimizëm, sepse do të ndikojnë edhe në rritjen e numrit të vendeve të punës. Paralelisht, vendoset paga minimale 32 mijë lekë dhe ndërkohë përjashtohen nga taksa pagat deri në 40 mijë lekë dhe përgjysmohet taksa për pagat nga 40-50 mijë lekë, duke vijuar me nivelet e larta, për atë që ka qenë një tjetër kërkesë, për të rritur fashën nga 150 mijë në 200 mijë për ata që paguajnë 23% të tatimit mbi të ardhurat.

Më vjen mirë që një vëmendje të madhe marrin dhe punonjësit e policisë, nëpërmjet rritjes së pagave, si dhe ushtarakët me rritjen e pagave 30%, që gjithmonë e më shumë janë pranë komunitetit. Ata që shprehën në këtë sallë shqetësimin për borxhit, duhet të rrinë të qetë, sepse borxhi, përveç këtyre 2 vjetëve, do t'i kthehet trajektore rënëse, duke vijuar nga 80%, që është i pritshmi i 2021-shit, në 78,9% në vitin 2022, duke vijuar kështu me 67,9% në vitin 2028. Më vjen mirë që krahas uljes së borxhit, buxheti i ri do të mbështesë projektet për përmirësimin e sistemit të furnizimit me ujë dhe kanalizime, për furnizimin me energji elektrike, përmirësimin e menaxhimit të mbetjeve urbane, përmirësimin e planifikimit urban, zhvillimin e transportit ajror, detar e hekurudhor, si dhe

mbështetjen e burimeve natyrore dhe të industrisë. Nuk janë premtime, por projekte konkrete, si: përfundimi i punimeve në rrugën Kardhiq-Delvinë; Rruga e Arbrit; ndërtimi i tunelit të Llogorasë; ndërtimi i segmentit rrugor Palasë-Dhërmi; segmenti i Unazës së jashtme të Tiranës; ndërtimi i bajpasit perëndimor të Shkodrës; zgjerimi i segmentit në dalje të Elbasanit, Përrenjasit dhe Qafë-Thanës; mirëmbajtja e rrugëve nacionale me financim të brendshëm. Duke mos dashur të zgjatëm më shumë, të nderuar kolegë deputetë, është në nderin tonë të miratojmë këtë buxhet, që vjen jo vetëm si buxheti i shpresës, por dhe i realizimit të projekteve madhore infrastrukturore, mbi të gjitha, i rritjes ekonomike, e cila do të përkthehet direkt edhe në rritje pagash, vende të reja pune, lehtësira për bizneset, në përmbushje të të gjitha detyrimeve që kemi ndërmarrë. Ndaj ju ftoj ta votojmë atë. Ju faleminderit!